

VENDIM
Nr.351, datë 14.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pikat 2, paragrafi i parë, e 3, dhe 83, të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalja e fundit, e paragrafit të dytë të pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për shtetasit, të cilët hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, si dhe ata të cilët marrin vizë në kufi, kohëqëndrimi është 90 ditë për 180 ditë.”.

2. Në paragrafin e parë të pikës 10, togfjalëshi “... 90 ditë. . .” zëvendësohet me “... afati i përcaktuar në paragrafin e dytë të pikës 8...”.

3. Pikat 1 dhe 2 në lidhjen 8/1 “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shtetasit e huaj, me kombësi shqiptare, hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa vizë, për qëllime turistike, duke i paraqitur policisë kufitare çdo dokument të vlefshëm udhëtimi ose identifikimi.

Kjo pikë zbatohet për periudhën 1 maj — 31 tetor.

2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime turistike, hyjnë pa vizë shtetasit e shteteve të mëposhtme:

- Serbi;
- Bosnjë dhe Hercegovinë;
- Mali i Zi.”.

4. Në shtetet e përcaktuara në lidhjen 8 “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë me grupe turistike, të organizuara nëpërmjet agjencive turistike shqiptare, duke marrë në kufi vizë kolektive 72-orëshe, kundrejt pagesës.”.

5. Në lidhjen nr.8 “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, të bëhen shtesat e mëposhtme:

“a) Në listën “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë dhe pa pagesë (kur udhëtojnë me pasaporta diplomatike dhe shërbimi)”, të shtohen shtetet “Çekia, Estonia, Letonia, Lituania”.

b) Në listën “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaportë të thjeshtë”, të shtohet shteti “Brazil”.”.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha